

## VENDIM

Nr.520, datë 9.6.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.857, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të neneve 4, pika 2, shkronja "b", e 36 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Në vendimin nr.857, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Ministri i Shëndetësisë miraton statutin tip të qendrës shëndetësore."

2. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"11. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë që, në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, të ngrejë bordin e qendrave shëndetësore në nivel DSHP/ASHR, 30 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij projektvendimi."

3. Në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhen këto ndryshime:

a) Neni 23 ndryshohet, si më poshtë, si më poshtë vijon:

"Neni 23

Në nivel DSHP/ASHR, për Tiranën, ngrihet dhe funksionon Bordi i Qendrave Shëndetësore. Ky bord ka në përbërje të tij drejtorin e DSHP/ASHR, përfaqësuesin e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe përfaqësuesin e qarkut, në territorin e të cilit ushtron veprimtarinë DSHP.

Kryetari i Bordit të Qendrave Shëndetësore, në çdo DSHP/ASHR, është drejtori i DSHP/ASHR.

Bordi mblidhet jo më pak se 4 herë në vit. Bordi mund të mblidhet edhe jashtë radhe për raste të veçanta. Detyrat e bordit të qendrave shëndetësore dhe mënyrat e thirrjes së tij, përcaktohen në rregulloren e funksionimit të bordit të qendrave shëndetësore, e cila miratohet nga Ministri i Shëndetësisë."

b) Neni 24, shfuqizohet.

c) Neni 25 ndryshohet, si më poshtë vijon:

## "Neni 25

Drejtori i qendrës shëndetësore emërohet dhe lirohet nga Bordi i Qendrave Shëndetësore në nivel Drejtorie të Shëndetit Publik (DSHP)/Autoriteti Shëndetësor Rajonal për Tiranën (ASHR).

Detyrat e drejtorit të qendrës shëndetësore përcaktohen në statutin e qendrës shëndetësore, i cili miratohet nga Ministri i Shëndetësisë.

ISKSH-ja ka të drejtë që, kur konstaton keqmenaxhim të qendrës shëndetësore, bazuar në prova të shkruara, t'i kërkojë Bordit të Qendrave Shëndetësore shkarkimin e drejtorit."

ç) Neni 26 ndryshohet si më poshtë vijon:

## "Neni 26

Personeli i qendrës shëndetësore përbëhet nga stafi mjekësor dhe ai ndihmës. Personeli mjekësor emërohet dhe lirohet nga detyra nga Bordi i Qendrave Shëndetësore në nivel Drejtorie të Shëndetit Publik (DSHP/ASHR), sipas procedurave të rekrutimit, të përcaktuara nga Ministri i Shëndetësisë. Drejtori i qendrës shëndetësore përgatit dosjen e dokumenteve të kandidatëve që konkurrojnë për punësim dhe ia paraqet bordit.

Bordi i Qendrave Shëndetësore zhvillon procedurën e konkurrimit dhe, pas shpalljes së fituesit, autorizon drejtorin e qendrës shëndetësore të lidhë kontratë me fituesin, sipas Kodit të Punës.

Personeli ndihmës i qendrës shëndetësore emërohet nga drejtori i qendrës shëndetësore, sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Punës dhe normave të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë. Ankimi kundër vendimit të drejtorit të qendrës shëndetësore bëhet brenda 10 ditëve në Bordin e Qendrave Shëndetësore.

Vendimi i Bordit të Qendrave Shëndetësore është përfundimtar. Ankimi kundër vendimit të Bordit bëhet brenda 30 ditëve, në gjykatën e shkallës së parë."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

